



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISE SE QYTETIT KORÇE**

Vendim

Nr 8 date 8/02/2010

“Per transferimin ne pronesi te Bashkise Korçe te ”Senatoriumit” te qytetit te Korçes “

Keshilli i Bashkise Korçe pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike bazuar ne nenin 32 te ligjit nr.8652 dt 31.07.2009 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore “,ne ligjin nr 8743 date 22.12.2001 “Per pronat e paluajtshme te shtetit,dhe ligjit Nr. 8744 date 22. 12.2001 “Per transferimin e pronave te Paluajtshme Publike te Shtetit ne njesite e qeverisjes vendore.V.K.M-se nr 511 date 14.08.2001 “Per inventarizimin e e pronave te paluajtshme shtetnore dhe transferimin e e pronave organeve te qeverisjes vendore “

VENDOSI :

1. Te fillojnë procedurat per transferimin ne pronesi te Bashkise Korçe te ”Senatoriumit “ te qytetit te Korçes
2. Ti kërkohet Ministrise se Shendetesise dhe Agjensise se Inventarizimit dhe Transferimit te Pronave Publike (A.I.T.P.P) ,kalimi i pronesise se “Senatoriumit “ Bashkise Korçe, e cila do ta riktheje ate ne nje objekt funksional ne sherbim te komunitetit
3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere .

**Kryetari
Gjergji PENDAVINJI**